

RELACION TEKNIK

Objekti: “*Ndricimi Rrugor i Rrugeve te Fshatrave Gradishte, Hyse, Qafeshkalle & Dragot, Bashkia Belsh*”

SISTEMI ELEKTRIK

I. HYRJE

Projekt elektrik i “Ndricimit rrugor” duhet te respektoje te gjitha kushtet projektuese dhe standartet qe jane ne fuqi ne Shqiperi dhe per elemente te vecanta qe nuk parashikohen ne keto standarte duhet ti referohemi “Euro norms-EN”, “Euro standarteve - EN,ED” dhe “Rekomandimet te – CEI, CENELC, DIN VDI/VDE”.

Ketu jane dhe ne kerkesat e pergjithshme si edhe kushtet teknike te instalimit te nevojshme per te gjitha aksesoret dhe instalimet elektrike ne pergjithesi. Keto kerkesa te pergjithshme do te plotesohen sikurse jane treguar ne skicat dhe projektet si edhe ne pershkrimet dhe instruksionet e projektit.

II. ZONA KU DO TE ZBATOHET PROJEKTI

Projekti elektrik i “Ndricimit rrugor” parashikon realizimin e nje impianti te ri te ndricimit rrugor me shtylla metalike konike 6-8ml, si edhe me ndricues 60W ne rruget e brendshme te fshatrave:

- 1- Gradishte
- 2- Hyse
- 3- Qafe-Shkalle.
- 4- Dragot-Ferme

III. GJENDJA AKTUALE E NDRICIMIT RRUGOR :

Aktualisht ne zonen e nderhyrjes mungon totalisht ndricimi rrugor.

Me zhvillimin e ketij projekti perfitojne ne menyre direkte rreth 4200 banore, (afersisht 1300 familje), respektivisht:

Ne fshatin <i>Gradishte</i>	1247 Banore (353 Familje).
Ne fshatin <i>Hyse</i>	1053 Banore (350 Familje).
Ne fshatin <i>Qafe-Shkalle</i>	1147 Banore (345 Familje).
Ne fshatin <i>Dragot-Ferme</i>	734 Banore (260 Familje).

IV. QELLIMI I PROJEKTIT :

Qellimi kryesor I impiantit te ndricimit rrugor eshte te garantoje, gjate oreve te mbremjes kushte te mira shikimi si per mjetet e motorizuara ashtu edhe per kembesoret.

Impianti i ndricimit duhet te:

- Evitoje fenomenin e verbimit
- Ofroje nje uniformitet te ndricimit
- Garantoje nje shkalle maksimale mbrojtjeje ndaj kontakteve direkte dhe indirekte te pajisjeve ne tension
- Bej te mundur ne kushte sa me lehtesuese punet e mirembajtjes se ndricuesve
- Kenaq kriteret estetike ne harmonizim me ambientin rrethues

V. KARAKTERISTIKAT E IMPIANTIT TE NDRICIMIT :

Impianti i ndriçimit do te kete keto karekteristika kryesore te perbashketa:

1. Tipi i furnizimit - *furnizim te pavarur*
2. Menyra e vendosjes se ndriçuesve - *ne nje krah te rruges*
3. Menyra e furnizimit – *Panele fotovoltaike*
4. Tipi llampes se ndriçimit – *DEL-DN4-60 w.*
5. Ne zgjedhjen e lartesisë ne ndriçuesve perkundrejt gjerësisë se rruges duhet te kihet parasysh $h/L \approx 1$.
6. Pikat e ndricimit do te jene ne nje ane e rruges e jo me larg se 25-30m nga njera-tjetri.

VI. SHTYLLAT E NDRICIMIT:

Shtyllat e ndriçimit do te jene metalike tip konike me lartesi 6-8 m.

Karakteris tikat e shtyllave sipas lartesisë jepen si me poshte: Shtylla (ml) 6-8	I(ml)(thelle sia gropes)	D(mm)	d(mm)	s(mm)	Pesha (kg)	Krahu(mm)
	0.8	138	60	4	76	1500

Punoi: **Ing. Julmir BOJA**

JULMIR BOJA
ING. ELEKTRIK
LTD. E.1283